



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Kavajë, më ____ . ____ . 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z. RUDIN HYLVIU
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK KAVAJË

I nderuar z. Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues :

**“PËR PËRMIRËSIM TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KOPSHTEVE TË
BASHKISË KAVAJË”, “PËR KTHIMIN PJESËRISHT TË KOPSHTEVE TË
NJËSIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE LUZI VOGËL NË KOPSHTE ME
USHQIM”**

Me respekt,

KRYETARI
FISNIK QOSJA

Miratoi:

EDMOND ÇURUMI

Drejtor i Arsimit Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të
Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore

Datë :

Nr.i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues: _____

Nr.i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt-vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot.

Kavajë, më _____. _____. 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë _____ . _____ 2025

“ PËR PËRMIRËSIM TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KOPSHTEVE TË BASHKISË KAVAJË ”, “ PËR KTHIMIN PJESËRISHT TË KOPSHTEVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE LUZI VOGËL NË KOPSHTE ME USHQIM ”.

- Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë Neni 57, pika 1, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSF” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018, Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”; Kreu II, “Arsimi Parashkollor”, Udhezimit nr.14 date 10.7.2023 “Per numrin e nxenesve per klase dhe ngarkesen mesimore te punonjesve arsimore”, VKB Nr. 68 datë 23.12.2024, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”, Kryetari Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e radhës:

TË VENDOSI:

1. Në Arsimi Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore, hapjen e kopshteve me ushqim në Njësitë Administrative Golem dhe Luzi Vogël.
2. Në Arsimi Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore, shtohet numri i punonjësve me 11 (njëmbëdhjetë) duke përfshirë dy kuzhinierë, dy ndihmës kuzhinierë, tre edukatore, një pjatlarëse, një sanitare dhe dy roje, sipas lidhjes nr 2.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Ekonomike dhe Arsimi Parashkollor.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë edhe relacionin shoqërues dhe shpjegues i detajuar, bazuar në ligjishmëri.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Frida Gjuzi

DREJTORIA LIGJORE
Adrian Malaj

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE
Andi Çurgu

DREJTORIA ARSIMIT PARASHKOLLOR PARAUNIVERSITAR DHE QENDRAT KULTURORE

Edmond Çurumi

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
Meri Biturku



KRYETARI
FISNIK QOSJA



Perillogaritje page

Pozicioni	Paga Baze	Paga e Grupit	Shtese Kualifikim	Vjetersi (15 vite)	Paga Bruto	Sig shoq & shendet	Totali
Edukatore	58,000	14,000	4,200	5,800	82,000	13,694	95,694
Edukatore	58,000	14,000	4,200	5,800	82,000	13,694	95,694
Edukatore	58,000	14,000	4,200	5,800	82,000	13,694	95,694
Kuzhinieri	46,800			7,020	53,820	8,988	62,808
Kuzhinieri	46,800			7,020	53,820	8,988	62,808
Nd.Kuzhinieri	45,000			6,750	51,750	8,642	60,392
Nd.Kuzhinieri	45,000			6,750	51,750	8,642	60,392
Pjatalarese	44,000			6,600	50,600	8,450	59,050
Sanitare	44,000			6,600	50,600	8,450	59,050
Roje	44,000			6,600	50,600	8,450	59,050
Roje	44,000			6,600	50,600	8,450	59,050
Totali per 1 muaj							769,683
Totali per 1 vit							9,236,198





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
AGJENCIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË
ARSIMIT PARASHKOLLOR, PARAUNIVERSITAR DHE QENDRA KULTURORE

Nr. _____ Prot.

Kavajë, më _____. _____. 2025

RELACION

- ◆ **Për përmirësim të sistemit të menaxhimit të kopshteve të Bashkisë Kavajë**
- ◆ **Për kthimin pjesërisht të kopshteve të njësive Administrative Golem dhe Luzi Vogël në kopshte me ushqim.**

Të nderuar,

Arsimi konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Kavajë dhe me një ndjeshmëri të lartë në komunitet. Bashkia Kavajë nëpërmjet Agjencisë së Arsimit Parashkollor Parauniversitar, i ka patur gjithmonë në qendër të vëmendjes kopshtet dhe e ka parë të nevojshme të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme infrastrukturën e kopshteve, të ofrojë në mënyrë të vazhdueshme kushte të përshtatshme higjieno – sanitare, të përmirësojë mjetet logjistike dhe didaktike, të rrisë kapacitetet për përmirësimin e ofrimit të shërbimit, etj. për të siguruar shërbim cilësor në Arsimin Parashkollor. Në këtë kuadër, përmes investimeve në këtë sektor, Bashkia Kavajë ka patur si prioritet të saj të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e shërbimit të ofruar për çdo fëmijë.

Një nga problematikat e vërejtur që ka marrë vëmendjen e Bashkisë, është ofrimi i ushqimit në kopshte. Sipas të dhënave, është vërejtur që ka një kërkesë të lartë për regjistrime në kopshtet me **drekë**. Për këtë arsye bashkia ka parë me vëmendje mundësinë e shtimit të kopshteve me drekë, në mënyrë që të plotësojë nevojat e komunitetit jo vetëm në qytet por edhe në të gjitha njësitë administrative dhe vecanërisht në Njësitë Administrative Golem dhe Luzi i Vogël.

- **Përse një kopsht me ushqim?**
- **Përse në Golem dhe Luzi Vogël?**

Ju bëj me dije se kopshti Golem, deri më tani, e ka ushtruar veprimtarinë mësimore – edukative brenda ambjentëve të shkollës 9-vjecare. Aktualisht ka në përbërje një staf mësimor prej **5(pesë)** edukatoresh dhe një numër fëmijësh prej **112** gjithsej, të regjistruar për vitin mësimor **2024-2025**.

Kërkesat gjithmonë në rritje të banorëve dhe numri i fëmijëve të regjistruar, bëri të mundur ndërtimin e një objekti të ri, të vecuar nga shkolla 9-vjecare, e cila do të funksionojë si kopsht dhe cerdhe për të gjithë fëmijët e zonës së Golemit dhe më tutje.

Objekti i ri i ndërtuar në Golem është ndërtesë 2 katëshe ndërsa objekti i ndërtuar në Njësinë Administrative Luzi Vogël është objekt 3 katësh. Të dyja objektet, janë ndërtuar me qëllimin për të shërbyer si **kopsht dhe cerdhe** në të njëjtën kohë dhe si e tillë i plotëson të gjithë parametrat e kërkuar, për të qenë njëkohësisht edhe kopsht me drekë.

Një e dhënë e rëndësishme është gjithashtu fakti që Golemi është një zonë turistike me potenciale ekonomike të fuqishme dhe me tendencë në rritje të popullsisë, gjë që patjetër do të reflektojë edhe në kërkesën në rritje për regjistrim të fëmijëve në kopsht me ushqim dhe cerdhe. Ndërkohë që edhe Luzi i Vogël, është një zonë ku përmbledh një numër të konsiderueshëm fshatrash përreth, me një numër banorësh të cilët gjithnjë e më shumë, preferojnë ti regjistrojnë fëmijët në kopsht me ushqim.

Kërkesa në rritje të prindërve për shërbimin e drekës, ka bërë që fëmijët e zonës Golem dhe Luzi Vogël, të regjistrohen në kopshtet e qytetit Kavajë dhe në këtë mënyrë, kopshtet që e ofrojnë këtë shërbim, të jenë mbi kapacitet. Kjo për pasojë, ka sjellë shpenzime të paparashikuara për familjarët e zonës së Golemit dhe të Luzit të Vogël. Regjistrimet mbi kapacitet në qytet sjellin gjithashtu edhe probleme në efikasitetin e ulët gjatë procesit të edukimit dhe nxënies së fëmijës.

Planifikimet tona, të mbështetura edhe në kërkesat me shkrim të prindërve të fëmijëve, janë që të kthehet në kopsht me ushqim fillimisht njëri nga grupet dhe në vitin 2025 - 2026 edhe grupi tjetër në varësi të kërkesave të komunitetit.

Për të gjitha këto arsye, është e rëndësishme që kopshti Golem dhe kopshti Luzi Vogël **pa ushqim**, të mund të kthehet në **kopsht me ushqim** pasi i përmbushin të gjitha standartet infrastrukturore dhe në këtë mënyrë, plotësojmë kërkesat në rritje të banorëve të zonës.

Nr	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Fakt Aktual
1.	Numri i fëmijëve që frekuentojnë çdo ditë kopshtin	Golem	112
2.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht me ushqim	Golem	50
3.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht pa ushqim	Golem	62

Nr	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Fakt Aktual
1.	Numri i fëmijëve që frekuentojnë çdo ditë kopshtin	Luzi Vogël	52
2.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht me ushqim	Luzi Vogël	25
3.	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht pa ushqim	Luzi Vogël	27



Me rëndësi gjithashtu është edhe fakti që:

- Projekti i ndërtimit të kopshtit Golem dhe i kopshtit Luzi Vogël, **është i konceptuar që në ndërtim** si kopsht me drekë (**ushqim**) dhe është krejtësisht **brenda parametrave** të kërkuara nga ana teknike;
- Kopshtet e sapondërtuar **janë lehtësisht të aksesueshme** nga popullata e interesuar për shërbimin;
- Mjedisi fizik, i përmbush standardet normative **infrastrukturore të objektit që funksionon dhe garanton sigurinë fizike të fëmijëve në kopsht**;
- Ambiente të brendëshme tërësisht të planifikuara për klasa mësimore, kuzhinë, dhoma ngrënie dhe fjetje, dhomë mjeku, sallë pritjesh për prindrit etj;
- Ambjentet e brendëshme janë të kompletuara dhe pajisura plotësisht me bazën materiale të nevojshme për fillimin e punës normalisht dhe konkretisht me krevate për fëmijët, tavolina dhe karrige, pajisje të domosdoshme të kuzhinës etj;
- Ambiente të jashtëm të pajisura me kënd lojrash dhe ambjente të tjera për sport dhe argëtim;
- Kopshti është i aksesueshëm dhe në një pozicion gjeografik tejte të përshtatshëm me hyrje të vecantë nga ambjentet e shkollës 9- vjecare;

- Qëllimi i kopshtit nuk është vetëm t'ju vijë në ndihmë prindërve me orarin 8:00-16:00, por edhe të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e fëmijës që vjen nëpërmjet lodrave, socializimit dhe mësimi në grup;
- Ushqimi në kopsht nuk duhet parë thjesht si një proces i ngrënies së një apo disa vakteve. Duhet parë në kuadrin e procesit të edukimit të fëmijëve.

Për ta bërë këtë të mundur, kërkohet **ndërhyrje ligjore** dhe më konkretisht:

1. Miratimi në Këshillin Bashkiak i planit dhe buxhetit për kthimin e kopshtit Golem, në kopsht me drekë;
2. Planifikimi i punës dhe kostove për kthimin e **kopshtit Golem** në kopsht me drekë;
3. Miratimi i planit dhe buxhetit, në Këshillin Bashkiak;
4. Hapja e procedurave të prokurimit publik dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik;
5. Punësimi i burimeve njerëzore të nevojshme;

- **Kopshti Golem**

Paga për: 1 (një) kuzhinier/e,
1 (një) ndihmës kuzhinier/e,
1 (një) pjatolarëse,
1 (një) roje objekti
3 (tre) mësuese / edukatore.

- **Kopshti Luzi Vogël**

Paga për: 1 (një) kuzhinier/e,
1 (një) ndihmës kuzhinier/e (pjatolarëse),
1 (një) sanitare
1 (një) roje objekti



Ju faleminderit për bashkëpunimin,

Konceptoi:
Edmond Çurumi

Drejtori i Agjencisë së Arsimit Parashkollor, Bashkia Kavajë

Edmond Çurumi



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KAVAJË



Nr. Prot

Kavajë, me ____ . ____ . 2025

Relacioni i ndikimit financiar mbi “Permiresimit te sistemit te menaxhimit te kopshteve ne Bashkine Kavaje”

Korrik 2025





1. Kuadri ligjor

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore;
- Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr.3 date 28.02.2024 “Per Pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027” me shtojcat plotesuese
- Udhëzimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr.08 date 05.07.2024 “Per Pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027”
- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.
- Shkreses se Ministrise se Financave nr.14488 prot. Date 29.10.2024 “Dergohet per njoftim Transferta e Pakushtezuar e Pergjithshme dhe Sektoriale per Vitin 2025”

2. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
5. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.



3. Buxheti vendor 2025

Pushteti Vendor pas reformës administrativo territoriale dhe miratimit të ligjit bazë për financat e vetëqeverisjes vendore, hyri në një fazë të rëndësishme të konsolidimit fiskal të menaxhimit financiar publik. Reforma në modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor është një proces i iniciuar tashmë prej disa vitesh, e cila mori një dimension të ri zhvillimi pas reformës administrativo-territoriale, duke dhënë rezultate në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore. Në këtë drejtim, janë ruajtur treguesit pozitiv të rritjes së rolit të pushtetit vendor në forcimin e kapacitetit fiskal.

Pushteti vendor ka bërë progres të dukshëm në konsolidimin e menaxhimit financiar, por gjithashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në nivel vendor. Reformat e zhvilluara në vite për modernizimin e financave vendore, kanë dhënë rezultate në përmirësimin e treguesve fiskalë, në konsolidimin financiar dhe përmirësimin metodologjik të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.

Financat vendore janë një shtyllë e rëndësishme e agjendës së decentralizimit, duke krijuar mundësi që qeveritë vendore të kenë më shumë burime financiare, që ato të kryejnë funksionet dhe kompetencat e tyre në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme. Përgjegjësitë në rritje të qeverisjes vendore sjellin nevojën e rritjes së peshës së të ardhurave dhe shpenzimeve vendore ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, në veçanti rritja e të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e veta dhe taksat e ndara.

Reforma në financat vendore është fokusuar edhe në reformimin e sistemit buxhetor vendor me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për fondet publike vendore. Kjo do të vijojë edhe me ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Financiar në nivel vendor (AFMIS).

Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore janë:

- Forcimi i sistemeve të menaxhimit të financave publike dhe të informacionit financiar, nëpërmjet reformimit të sistemit buxhetor duke e bërë atë instrumentin kryesor të mirëmenaxhimit të shërbimeve publike për komunitetet vendore;
- Forcimi i disiplinës financiare duke ngritur një sistem monitorues dhe alertues për mirëmenaxhimin e financave publike vendore me qëllim paralajmërimin në kohë për njvqy-të që krijojnë detyrime të prapambetura;
- Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor, një tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike;
- Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale);
- Rritja e nivelit të pagave për pushtetin vendor, me një mbështetje buxhetore për mbulimin e efekteve financiare shtesë si rezultat i rritjes së kufirit minimal.



- Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale dhe Taksës së Rentës Minerare duke i dhënë mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të rritur efektshmërinë në ofrimin e shërbimeve;
- Konsolidimi i procedurave të buxhetimit dhe sistemit të menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njvqv-ve, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Prezantimi i një sistemi të ri (soft online) për përgatitjen e PBA-së dhe buxhetit vjetor, për të ndihmuar njvqv-të dhe ministrinë në përgatitjen e buxhetit vendor, PBA vendore dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit.
- Përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
- Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Forcimi i sistemit të mbikëqyrjes financiare të njvqv-ve nga qeveria qendrore me qëllim të mbështetjes së njësive vendore në probleme/vështirësi financiare.
- Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm, por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme me njvqv-të në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit SMBV në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

Të gjitha arritjet e mësipërme në drejtim të qeverisjes vendore, janë një tregues i rëndësishëm për rritjen e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët. Në funksion të reformimit dhe modernizimit të financave publike dhe kryesisht atyre vendore, në strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike është parashikuar që në vitet e ardhshme sistemi i AFMIS-it të jetë i zgjeruar dhe në nivel vendor duke sjellë një vlerë të shtuar të Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor.

Ne mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017



“Per financat e veteqeverisjes vendore, ligjit nr.9632 “ Per sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 10296 “ Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ne Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.68, date 23.12.2024 “Per miratimin e programit buxhetor afatmesem 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Tirane me shkresen nr.1747/1 prot, date 31.12.2024“Verifikim ligjshmerie”dhe Buxheti i Trasheguar i miratuar me VKB nr.06 date 25.02.2025,Verifikim ligjshmerie me shkresen nr.880/3 ,date 12.03.2025.

Referuar Projekt Vendimit “**Per permiresim te sistemit te menaxhimit te kopshteve te Bashkise Kavaje**”, “**Per kthimin pjesisht te kopshteve te njesive administrative Golem dhe Luz I Vogel ne Kopshte me ushqim**” dhe Relacionit nga Agjencia e Arsmit Parashkollor dhe e Sherbimeve Mbeshtetese te Arsmit Parashkollor,Parauniversitar dhe Qendra Kulturore,pergatitur nga Drejtori Edmond Çurumi duke e analizuar me detaje arsyet e shtimit te personelit ne kopshtet perkatese dhe ofrimin e nje sherbimi me te mire per femijet te cilet jane konkretisht 112 femije ne Kopshtin e Golemit te ndare 50 me sherbim ushqimi dhe 62 pa ushqim dhe 52 femije ne Kopshtin Luz i Vogel te ndare ne 25 femije me sherbim ushqimi dhe 27 femije pa sherbim ushqimi. Me rendesi eshte edhe fakti qe keto ndryshime qe do ndikojne ne permiresimin e ofrimit te sherbimit ne kopshtet perkatese,qe jane te konceptuara qe ne ndertimin e kopshteve te ndertuara brenda parametrave,te cilat jane lehtesisht te aksesueshme nga popullata.

Per sa me siper,duke i'u referuar Relacionit te Drejtorit te Agjencise se Arsimit Parashkollor, ndikimi buxhetor qe preket ne Buxhetin e vitit 2025 eshte ne vleren 769,683 per cdo muaj dhe per vitin 2025,efekti total financiar do nisi qe nga data 01.08.2025 qe kap vleren rreth 3,848,415.

Vlera rreth **3,848,415** do te transferohet nga fondi i pagave ne Buxhetin e Trasheguar me VKB.06 date 25.02.2025 ne pasqyren nr.2&3,Pasqyra llog.600+601(Paga personeli+sigurime) eshte miratuar ne vleren 56,458,000 te ndare 27,000,000 leke ne kapitull 01 dhe 29,458,000 me kapitull 01(Transferte e Pakushtezuar Sektoriale),ne programin 1110.

Vlera 27,000,000 leke me kapitull 01(Transferte e Pakushtezuar e Pergjithshme) do te pakesohet per t'u transferuar ne (llog.600) ne vleren $659,541 * 5 \text{ muaj} = 3,297,705$ leke Paga personeli
(llog.601) ne vleren $110,142 * 5 \text{ muaj} = 550,710$ leke Sigurime shoq&shendet

Totali 3,848,415 leke ne kapitullin 01(Tranferte e Pakushtezuar e Pergjithshme)do te tranferohet ne programin 9230 ne Arsimi Baze dhe Parashkollor te detajuar si me poshte:
3,297,705 ne llogarine paga 600
550,710 ne llogarine sigurime 601

Konceptoi
Erdi BERATI

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE

ANDI CURGU